



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA ADMINISTRATIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 746	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 15	
Data / Datum / Date: 30/07/2025		Pejë / Poë

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

P.A.nr.11/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Lumni Sallauka dhe Franciska Zhitija-Ymeri, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, në çështjen juridike në konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit: Halit Shabani, me adresë: Kroni i Bardhë, Villa nr.06, Dardani, Prishtinë, të cilin e përfaqëson Rrezon Hoxha, avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurit: Universiteti “Haxhi Zeka”, në Pejë, Rr. “UÇK”, të cilin e përfaqëson Luan Lulaj - Zyrtar për Përfaqësim, me bazë juridike: shfuqizimin e aktit nënligjor normativ - Rregullores për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, të datës 02.05.2025, me kërkesë për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur në praninë e palëve ndërgjyqëse, më datë 14.07.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht si e themeltë kërkesëpadia e paditësit: Halit Shabani, me adresë: Kroni i Bardhë, Villa nr.06, Dardani, Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurit: Universiteti “Haxhi Zeka”, në Pejë, Rr. “UÇK”.

II. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet paragrafi 10 i nenit 7, të Rregullores për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë e datës 02.05.2025.

III. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit: Halit Shabani, me adresë: Kroni i Bardhë, Villa nr.06, Dardani, Prishtinë, për tej asaj që është gjykuara në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, më të cilën ka kërkuar që të shfuqizohen edhe paragrafët 6, 7, 8, 9, 11 dhe 12 të nenit 7 të Rregullores për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, e datës 02.05.2025.



IV. Refuzohet kërkesa për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, me të cilën paditësi ka kërkuar ndalimin e prodhimit të pasojave juridike të Rregullores për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, e datës 02.05.2025, deri në vendosjen meritorë sipas kërkesëpadisë.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

VI. Ky aktgjykim merr formën e prerë menjëherë pas komunikimit të përmbajtjes dhe arsyetimit të tij palëve, dhe DETYROHET i padituri Universiteti “Haxhi Zeka”, me seli në Pejë, që të njëjtin ta publikojë në mënyrë të njëjtë sikurse të miratimit të saj.

A r s y e t i m

I. Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi Halit Shabani nga Prishtina, më datë 28.05.2025, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ të paditurës, përkatësisht Rregullores për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, e datës 02.05.2025, (tutje: akti i kontestuar). Ndërsa më datë 05.06.2025, ka parashtruar kërkesë për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit.

I autorizuari i paditësit, me padi/kërkesë për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që të shpall të paligjshëm dhe të shfuqizoj: paragrafët 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të nenit 7 të Rregullores për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik dhe Jo akademik në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Paditësi pretendon se paragrafët 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të nenit 7 të Rregullores kontestuese janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), Statutin e Universitetit “Haxhi Zeka” dhe parimet bazë të zgjedhjeve demokratike. Ai konsideron se këto dispozita përjashtojnë në mënyrë të pajustificuar dhe diskriminuese një kategori të personelit akademik nga e drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, duke vendosur kriterë të reja dhe kufizuese të cilat nuk janë të parashikuara në asnjë akt më të lartë juridik dhe që bien ndesh me dispozitat ekzistuese ligjore



dhe statutare. Sipas paditësit, këto kritere të shtuara në rregullore përbëjnë ndërhyrje të paligjshme në marrëdhënien e punës dhe në të drejtat përfaqësuese të personelit akademik, krijojnë pabarazi trajtimi mes stafit të rregullt dhe atij me kontrata të veçanta, cenojnë të drejtën për pjesëmarrje në jetën institucionale dhe përfaqësim të barabartë, dhe nuk kanë as bazë ligjore as legjitimitet material apo procedural. Po ashtu, ai thekson se rregullorja është miratuar pa respektuar procedurat e parapara në LPPA dhe pa konsultim të duhur publik, dhe se përmbajtja e saj është në kundërshtim me vetë Statutin e UHZ-së, i cili nuk njeh dallime të tilla për të drejtën për të kandiduar apo për të votuar në organet përfaqësuese të universitetit. Për këto arsye, paditësi kërkon shfuqizimin e paragrafëve 6-12 të nenit 7 të rregullores si dispozita të kundërligjshme, diskriminuese dhe antikushtetuese.

Përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit ka theksuar se: kërkohet të shfuqizohen paragrafët e cekura në petitum të kërkesëpadisë me theks të veçantë paragrafi 10 i nenit 7, i cili në mënyrë ekzkluzive prek paditësin, ngase përcakton se për pozitat e anëtarit të këshillit drejtues, rektor, prorektor dhe anëtar të senatit nuk mund të zgjidhen kandidatët për shkak të arritjes së moshës së detyrueshme për pensionim dhe të cilët nuk mund të ushtrojnë gjysmën e mandatit të plotë e që llogaritet data 1 tetor i vitit përkatës kur fillon mandati. Kjo dispozitë është bërë kryekëput për të eliminuar personat e caktuar që në efektin e saj është në kundërshtim me parimet themelore të të drejtës kushtetuese dhe administrative dhe ligjet përkatëse për barazi në të drejtën në kandidimit në institucione dhe pozita publike. Përderisa nuk kemi një dispozitë në ligjin për arsimin e lartë në zgjedhjet e përgjithshme apo statutin e universitetit për shkak të moshës, kjo dispozitë në fjalë i kufizon apo përjashton kandidatët bazuar në kapacitete jo profesionale apo legjitimitetin e tyre për të kandiduar apo në një gjendje potenciale të ardhshme.

Paditësi në cilësinë e palës në seancë ka deklaruar se: Neni konkret diskriminon dhe shkel drejtat elementare të njeriut, ngase në asnjë ligj nuk përkufizohet mosha, kur e arrin moshën ai del në pension por nuk i mohohet e drejta në konkurrim, andaj qëllimi është eliminimi i konkurrentëve. Neni 7 par.10 i shkel të drejtat elementare të njeriut dhe nuk gjen mbështetje në asnjë ligj.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka specifikuar.



Gjykata me aktvendimin e datës 29.05.2025, ka njoftuar të paditurin lidhur me padinë dhe kërkesën e ushtruar, dhe pretendimet për paligjshmërinë e aktit normativ të kontestuar nga paditësja, si dhe detyrimin për paraqitjen e dosjes së plotë të procedurës administrative dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën e çështjes. Gjithashtu, gjykata i ka informuar palët për të drejtat, detyrimet dhe pasojat juridike që lidhen me veprimet procedurale në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke u dorëzuar një kopje të padisë, së bashku me provat përkatëse të bashkëngjitura nga paditësi.

Gjykata pasi brenda afatit të përcaktuar ligjor nuk ka pranuar nga e paditura përgjigjen në padi dhe as dosjen administrative, përkundër faktit se i padituri është njoftuar, konfirmuar sipas fletë kthesës për dorëzim me postë të datës 09.06.2025, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 14.07.2025, si dhe ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 58 dhe 59 të Ligji Nr. 08/L-182 Për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 3 / 10 Janar 2024, Prishtinë, (tutje: LKA-së), në praninë e palëve ndërgjyqëse.

Pasi gjykata pas përfundimit të seancës ka pranuar përgjigjen në padi, e cila i ardhur me vonesë gjykatës, të njëjtën me njoftimin e datës 14.07.2025, ia ka përcjell të autorizuarit të paditësit duke i dhënë mundësinë që brenda afatit të përcaktuar të parashtroj kundërshtimet ndaj pretendimeve të paditurës.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës me përgjigje në padi, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, ka kërkuar nga Gjykata Supreme, që të refuzoj kërkesën e paditësit për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit dhe kërkesëpadinë e paditësit për ndalimin e prodhimit të efekteve juridike, shpalljes së paligjshmërisë dhe shfuqizimit të aktit nënligjor normative. Ka shtuar se: padia dhe të gjitha kërkesat e saj janë të pabazuara në ligj. Riformulimi i padisë është i qartë se janë cituar ligje të cilat nuk e rregullojnë fushën e arsimit të lartë por si shembull është referuar Ligji i Përgjithshëm për Zgjedhje në RKS si ato parlamentare dhe lokale, në asnjë pikë të padisë nuk është argumentuar që universiteti nuk ka të drejtë në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë, që të vetë rregullohet si strukturë organizative, menaxheriale dhe mandate e cila kompetencë buron nga ligji dhe statuti i universitetit. Plotësim-ndryshimi i rregullores së vitit 2025, e cila në 95 % të saj është identike me rregulloren e vitit 2023, gjatë rishikimit të kësaj rregulloreje janë eliminuar vetëm kuptimësit e mundshme të cilat për universitetin kanë qenë pengesë në zgjedhjet paraprake. Sa i përket mandateve, statuti i rregullon mandatet, ndërsa që të eliminohet dykuptimësia e mandateve



Këshilli Drejtues brenda kompetencave e ka specifikuar këtë çështje ku ka thënë se mandat do të llogaritet nëse një person ka mbajtur së paku gjysmë e mandatit të rregullt si ushtrues detyre, kjo ka lind për shkak se disa nga stafi i universitetit kanë mbajtur mandat si ushtrues detyre në kohëzgjatje prej 4 apo 5 vite për të cilin kundërshtonin të ju llogaritet mandat për këto arsye dhe eliminimin e të gjitha keqkuptimeve nga zgjedhjet e kaluara të universitetit, Këshilli Drejtues e ka përcaktuar dhe i ka vendosur këto ndalesa të cilat janë në harmoni të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë, i cili është ligj sektorial dhe statutin e universitetit. Ka shtuar se: Sa i përket pikës 10, Universiteti me datë 23.06.2025 ka shpallur konkursin për rektor të universitetit por në bazën ligjore të tij nuk e ka përfshirë ndalesën që këto dhe në universitet mund të citohet si e jashtëligjshme pra Universiteti nuk ka pranuar asnjë ankesë të brendshme për të gjithë procesin dhe aktin që është kontestues pranë kësaj gjykate. Duke theksuar se: palët nuk kanë shteruar mjetet e brendshme juridike për pikat e nenit 7 të rregullores ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet padia dhe të mbetet në fuqi akti i nxjerr nga Këshilli Drejtues.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

II. Vlerësimi i gjendjes faktike dhe provat e administruara

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.07.2025, ka administruar provat relevante dhe atë: Rregulloren për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik dhe Jo Akademik në Universitetin "Haxhi Zeka", në Pejë, nr.911, të datës 02.05.2025; Shtojca Nr.1 - Formulari për Aplikim; Shtojca Nr.2 - Formulari për Ankesa; Komunikim me email, ndërmjet të Halit Shabani tek Gentiana Gega etj., e datës 15.04.2025, me titull "Propozimet e FB; Fakulteti i Biznesit - Përgjigje në dëgjimin publik për Rregulloren; Komunikim me email, ndërmjet të Adem Dreshaj tek Halit Shabani, me titull: Komentet, e datës 10.04.2025; Shkresa me titull: Vërejtje dhe sugjerim për ndryshimin e pikës 10 të nenit 7 të Draft Rregullores (pa numër protokolli, datë, emër apo nënshkrim); Vendim nr.prot.932, të datës 06.05.2025, për shpalljen e zgjedhjeve të përgjithshme në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë; Shkresa me titull: Dinamika e Procesit Zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë për vitin 2025, nr.prot.1167, e datës 22.05.2025.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 dhe 100 paragraf 1 nën-paragraf 1.1 të Ligjit nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë



10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit kontestues në drejtim të thënies në padi, thënies në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, ka konstatuar se: nga shkresat e lëndës rezultojnë se: Këshilli Drejtues i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025, ka nxjerr Rregulloren Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë.

Aktin nënligjor normativ të kontestuar, i padituri e ka nxjerr në mbështetje të nenit 23 të Statutit dhe në pajtim me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e mënyrës së organizimit të zgjedhjeve në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë si dhe procedurat zgjedhore në kuadër të këtyre zgjedhjeve. 2. Kjo rregullore zbatohet vetëm për zgjedhjet në organet e UHZ-së (Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi i rregullores). Të gjitha rregullat dhe procedurat zgjedhore, siç përcaktohen me këtë rregullore, bazohen në Statutin e UHZ-së si dhe legjislacionin në fuqi i cili është relevant përkitazi me çështjet që rregullon kjo rregullore. 2. Secila palë e pakënaqur lidhur me procedurat zgjedhore ka të drejtë ankese kundër vendimeve të nxjerra në kuptim të kësaj rregulloreje (Neni 2 Dispozitat e përgjithshme).

Neni i kontestuar (Neni 7 Kufizimet në të drejtën e zgjedhjes), ka përcaktuar se: 6. Me qëllim të shmangies së konfliktit eventual të interesit, të drejtë për tu zgjedhur në organet drejtuese të UHZ-së, sipas këtij neni nuk kanë të gjithë ata që përfaqësojnë dhe mbrojnë UHZ-në në organet administrative dhe gjyqësore, në të cilat organe vendimet e UAZ-së mund të kontestohen nga palët e pakënaqura. 7. Organe drejtuese në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni përfshijnë përfaqësimin në organet si në vijim: anëtare, i Këshillit Drejtues, Rektor, Dekan. 8. Për pozitën rektor dhe prorektor nuk mund të zgjedhen anëtarët e Këshillit Drejtues të UHZ, pa kaluar afati prej 2 viteve nga momenti i përfundimit të mandatit të anëtarit të Këshillit Drejtues të UHZ, për shkak të parandalimit të konfliktit të interesit. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të zgjedhen anëtarë të Senatit, Dekan, Prodekan, dhe anëtarë të Këshillit të Fakultetit me kusht që të japin dorëheqje paraprakisht nga pozita. 9. Për pozitën e rektorit, prorektorit, dekanit, prodekanit, nuk mund të zgjedhen kandidatët të cilët kanë ushtruar këtë detyrë për dy (2) mandate katër (4) vjeçare. 10. Për pozitën e anëtarit të Këshillit Drejtues, rektor, prorektor, dekan, prodekan, anëtar i senatit, nuk mund të zgjedhen kandidatët të cilët pengohen që ta ushtrojnë së paku gjysmën e mandatit të plotë për shkak të plotësimit të moshës mandatore të pensionit. Gjysma e mandatit llogaritet nga data e fillimit të mandatit me 1 tetor të vitit përkatës kur e



fillon mandatin. 11. Në rastet e kontestueshme, në lidhje me të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi i shkallës së parë merret nga KZF dhe KZAQ, me rastin e verifikimit të kandidaturave, kurse vendimi i shkallës së parë mund të ankimohet në KQZ-UHZ. 12. Lidhur me ankesën e ushtruar sipas kësaj rregulloreje, KQZ/UHZ, nxjerr vendim përfundimtar në procedurë administrative dhe duhet ta arsyetoj siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i KQZ-së është përfundimtar.

III. Dispozitat relevante kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe në fuqi nga data 15 qershor 2008

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]: “3. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]: “2. Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë”.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]: “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”.

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]: “4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël”.

Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare Nr.3, i miratuar më 14 dhjetor 2023, dhe në fuqi nga data 10 janar 2025

Neni 3 [Përkufizimet] “1. Në këtë ligj termet e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga



Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”.

Neni 5 [Parimi i ligjshmërisë] “Gjykata kompetente shqyrton konfliktin dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Neni 10 [Organizimi dhe Kompetenca] “4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ”.

Neni 11 [Përbërja në gjykim] “3. Gjykata Supreme, gjykon lëndën në kolegji të përbërë prej tre (3) gjyqtarësh”.

Neni 13 [Llojet e padive] “1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”).

Neni 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], “1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre. 3. Mbjatësit e interesave kolektive apo mbajtësit e interesave të gjera të publikut, gjithashtu, mund të ngrenë këtë padi nëse pretendojnë se akti është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë shkak ka cenuar apo mund ta cenojë në të ardhmen interesin kolektiv apo përkatësisht atë të gjerë të publikut. 5. Në padinë kundër aktit nënligjor normativ, i paditur, është organi publik që ka miratuar aktin. 7. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ paraqitet në çdo kohë për sa akti është në fuqi, madje edhe pas miratimit por para publikimit të detyrueshëm të aktit, për efekt të hyrjes të tij në fuqi”.

Neni 59 [Procedimi i padisë me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], “7. Në rast se kolegji shqyrtues nuk vjen unanimisht në përfundim se padia nuk është e lejueshme, cakton dhe thërret seancën gjyqësore dëgjimore dhe shqyrton në tërësi lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës dhe merr vendim sipas dispozitave të këtij ligji. 8. Në shqyrtimin e themelësisë së padisë, Gjykata vlerëson përmbajtjen, formën dhe procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të aktit nënligjor normativ të kontestuar”.



Neni 99 [Masat e posaçme të sigurimit të padisë në konfliktet administrative] “2. Për sigurimin e padisë në rastin e padive për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ administrativ, Gjykata me kërkesë, mund të vendosë për moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të aktit nënligjor normativ”.

Neni 100 [Kushtet për marrjen e masave të përkohshme të sigurisë] “1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik”. 2. Për marrjen e masës së sigurisë të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 99 të këtij Ligji, Gjykata shqyrton plotësimin e kushteve të nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të këtij neni në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Ligji Nr. 04/L-037 Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 14 / 9 Shtator 2011, Prishtinë

Neni 2 [Parimet] “1. Ofrimi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës bazohet në parimet si në vijim: 1.3. mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim”.

Ligji Nr. 05/L -021 Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 16 / 26 Qershor 2015, Prishtinë

Neni 1 [Qëllimi] “1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë”.



Neni 2 [Fushëveprimi] “1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: 1.1. kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet”, dhe “1.14. pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur”.

Neni 3 [Koncepti i diskriminimit] “1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji”.

Kolegji i gjykatës, pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit si dhe shpalljen e paligjshmërisë dhe shfuqizimit të aktit nënligjor normativ të kontestuar, përkatësisht paragrafëve: 6, 7, 8, 9, 10, 11, dhe 12 të nenit 7 të tij, ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë.

IV. Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ të kontestuar

Pas shqyrtimit të pretendimeve të paditësit dhe argumenteve të paraqitura nga të dyja palët, gjykata fillimisht ka vlerësuar se akti nënligjor normativ i kontestuar, përkatësisht Rregullorja për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik në Universitetin “Haxhi Zeka”, në Pejë, e datës 02.05.2025, është miratuar në përputhje me parimet dhe kërkesat procedurale të përcaktuara në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), si dhe procesin e konsultimit publik i cili është provuar me provat shkrese, prandaj pretendimi i paditësit për shkelje procedurale është i pabazuar. Andaj, Gjykata vlerësimin dhe arsyetimin e ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ të kontestuar e ka përqendruar vetëm në përmbajtjen e tij në aspektin material, pasi nuk gjeti të meta në aspektin formal të procedurës, përkatësisht gjykata shqyrtoj vetëm ligjshmërinë e paragrafëve: 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të nenit 7 të aktit nënligjor normativ kontestues. Mbi këtë bazë, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i paditësit se akti nënligjor normativ i kontestuar, përkatësisht se paragrafi 10 i nenit 7 të saj, është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kushtetuese është i bazuar.



Paragrafi 10 i nenit 7 të Rregullores thekson se: *“Për pozitën e anëtarit të këshillit drejtues, rektor, prorektor dhe anëtar të senatit nuk mund të zgjidhen kandidatët që, për shkak të arritjes së moshës së detyrueshme për pensionim, nuk mund të ushtrojnë gjysmën e mandatit të plotë.”* Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate ky kufizim nuk është i paraparë në Ligjin Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, dhe në as ndonjë ligj apo ndonjë akt tjetër me fuqi më të lartë juridike që do të justifikonte një ndalim të tillë. Për më tepër, i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kushtetuese, si dhe standardet ndërkombëtare ngase në mënyrë automatike dhe të drejtpërdrejtë përjashton kandidatët për kandidim për pozitën e anëtarit të këshillit drejtues, rektorit, prorektorit apo anëtarit të senatit, për shkak të arritjes së moshës së detyrueshme të pensionimit, në përpjestim me gjysmën e mandatit të plotë.

Kufizimi i përcaktuar për të qenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe parimin e proporcionalitetit, duhet të: jetë i përcaktuar me ligj, të ketë qëllim legjitim dhe të jetë i domosdoshëm dhe proporcional me qëllimin që synohet të arrihet. Çdo kufizim që ndalon pjesëmarrjen në pozita publike ose institucionale, për shkak të moshës, pa një arsyetim objektiv dhe proporcional, përbën shkelje të drejtave të barazisë dhe diskriminim. Ky kufizim në par. 10, siç argumentohet edhe nga paditësi, bazohet në një gjendje hipotetike të së ardhmes (mosha në fund të mandatit) dhe jo në një gjendje aktuale apo moshën aktuale të kandidatit, andaj edhe i njëjti nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore.

Gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës për të përjashtuar paditësin nga e drejta për të kandiduar për një pozitë drejtuese brenda Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, bazuar në moshën e tij, është në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Statutit të vetë Universitetit. Konkretisht, nenet 31 paragrafi 1 pika 1.5, 37 paragrafi 1 pika 1.5, 70 paragrafi 1 pika 1.5 dhe 71 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit përcaktojnë në mënyrë të qartë se: “Mandati i rektorit, dekanit dhe prodekanit mund të përfundojë para kohe në rast të pensionimit”.

Nga formulimi i këtyre dispozitave rrjedh se Statuti i Universitetit, nuk parashikon asnjë ndalim a kufizim paraprak lidhur me moshën e kandidatit në momentin e kandidimit për funksionet drejtuese të lartpërmendura. Përkundrazi, nga përmbajtja e tyre kuptohet se arritja e moshës për pensionim nuk përbën pengesë për kandidim, por mund të shërbejë vetëm si bazë për përfundimin të parakohshëm të mandatit, nëse gjatë ushtrimit të funksionit ndodh pensionimi i rregullt i personit të emëruar. Kjo do të thotë se vetë normat e brendshme të të paditurës e pranojnë mundësinë që një person në prag pensionimi të kandidojë dhe të zgjidhet në një



funkcion drejtues universitar, me kushtin që nëse gjatë mandatit të tij ai pensionohet, atëherë mandati përfundon në atë moment.

Për më tepër, Gjykata konsideron se një kufizim i tillë paraprak, që ndalon kandidimin vetëm mbi bazën e moshës së kandidatit, pa asnjë dispozitë të shprehur ligjore ose statutore që e autorizon këtë, përbën një cenim të së drejtës për qasje të barabartë në funksionet publike, si dhe një ndërhyrje disproporcionale në të drejtën për të kandiduar dhe për t'u përzgjedhur. Gjykata vlerëson gjithashtu se kufizimet në ushtrimin e së drejtës për të kandiduar në pozita publike mund të vendosen vetëm kur ato parashikohen shprehimisht me ligj, janë të arsyetuara në një shoqëri demokratike dhe janë proporcionalisht të lidhura me një qëllim legjitim. Në rastin konkret, përjashtimi i paditësit nga kandidimi për shkak të moshës së tij, pa asnjë dispozitë të qartë ligjore apo statutore që e ndalon këtë, dhe në mungesë të ndonjë analize funksionale apo arsytimi që do të justifikonte një kufizim të tillë, përbën një veprim administrativ arbitrar dhe të paligjshëm.

Për këto arsye, Gjykata konstaton se akti nënligjorë i të paditurës i cili në rastin konkret pa mundëson kandidimin e paditësit për shkak të moshës së tij është në kundërshtim me Statutin e Universitetit, me parimet e përgjithshme të së drejtës administrative, si dhe me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e të paditurit, megjithatë të njëjtat i ka refuzuar si të pathemelta dhe të paqëndrueshme. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se megjithëse vetë diskriminimi për shkak të moshës nuk përfshihet brenda sferës së të drejtës së veçantë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), çështjet e diskriminimit për shkak të moshës mund të lindin në kontekstin e të drejtave të ndryshme. Si në fusha të tjera, GJEDNJ ka gjykuar çështje të tilla, faktet e të cilave sugjerorin diskriminim për shkak të moshës - në veçanti në lidhje me trajtimin e moshës së pensionimit të detyrueshëm. Për më tepër Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka konstatuar se *“mosha”* është e përfshirë tek *“statusi tjetër”*. Andaj, në frymën e interpretimit të GJEDNJ-së, edhe kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret *“mosha”* sipas legjislacionit pozitiv gjen mbështetje në *“bazat e tjera”*, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Në anën tjetër, edhe Direktiva për Barazinë në Punësim (Direktiva 2000/78/KE), ndalon diskriminimin në bazë të orientimit seksual, besimit fetar, moshës dhe aftësisë së kufizuar në punësim. Ndërsa një kufizim i tillë sipas kësaj direktive duhet të ndërmerret vetëm nëse është i justifikuar dhe proporcional sipas nenit 6 të saj, *“Pavarësisht nga Neni 2(2), Shtetet Anëtare mund të vendosin që trajtimet e ndryshme për*



shkak të moshës nuk do të konsiderohen diskriminim, nëse, në kuadër të ligjit kombëtar, ato janë objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme të justifikuara nga një qëllim legjitim, duke përfshirë politika legjitime të punësimit, objektiva të tregut të punës dhe të trajnimit profesional, dhe nëse mënyrat për arritjen e atij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme”.

Gjykata, lidhur me pjesën refuzuese të kërkesës së paditësit është bazuar në nenin 70 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se: *“Gjykata deklaron paligjshmërinë dhe shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të aktit nënligjor normativ i cili është në kundërshtim me ligjin”*. Në këtë rast, paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme ose argumente juridike që e vërtetojnë se paragrafët tjerë të nenit 7 të Rregullores kontestuese janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën ose me ligjin. Gjykata ka shqyrtuar paragrafët e kontestuar nga paditësi dhe ka konstatuar se vetëm paragrafi 10 i nenit 7 është i paligjshëm. Andaj, në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ndërhyrja e gjykatës duhet të jetë proporcionale dhe të fokusohet vetëm në ato dispozita që vërtet shkelin të drejtat ose parimet ligjore dhe kushtetuese. Gjykata nuk mund të shfuqizojë tërësisht një akt nënligjor nëse paligjshmëria është e shprehur vetëm pjesërisht dhe e kufizuar në disa dispozita. Shfuqizimi total do të përbënte një ndërhyrje të tepërt në kompetencat dhe diskrecionin e bartësit publik të licencuar dhe të akredituar të arsimit të lartë dhe do të binte ndesh me parimin e ndërhyrjes minimale, të garantuar me Kushtetutë dhe me ligjet përkatëse. Prandaj, është bërë shfuqizimi vetëm i paragrafit 10 të nenit 7 të rregullores së kontestuar, ndërsa paragrafët 6, 7, 8, 9, 11, dhe 12 të nenit 7 të rregullores mbeten në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 319 par. 1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), i cili përcakton se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Ndërsa sipas nenit 322 përcaktohet se: *“2. Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”, dhe “3. Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”,* andaj nga këto dispozita ligjore del se në procedurë gjyqësore çdo palë ka për detyrë të vërtetojë pretendimet e saj dhe të ofrojë prova bindëse që mbështesin kërkesën.

V. *Vlerësimi i kërkesës për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit:*



Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për caktimin e masës së posaçme/përkohshme të sigurimit të padisë, si dhe bazuar në analizën e aktit nënligjor normativ përkatës, gjykata ka vlerësuar me kujdes rrethanat dhe kriteret ligjore të nevojshme për vendosjen e kësaj mase. Në fazën paraprake, pretendimet dhe argumentet e paditësit nuk janë konsideruar të mjaftueshme dhe të besueshme për të justifikuar vendosjen e masës së sigurimit, prandaj gjykata ka vijuar me shqyrtimin meritor të çështjes. Gjikata, pas shqyrtimit në merita të pretendimeve të paditësve dhe aprovimit të kërkesëpadisë, ka arritur në përfundimin se caktimi i masës së posaçme/përkohshme të sigurimit pas shpalljes së paligjshmërisë dhe shfuqizimit të paragrafit 10 të nenit 7 të aktit nënligjor normativ të kontestuar, nuk është i domosdoshëm dhe nuk do të kishte ndonjë efekt juridik.

VI. Vlerësimi i gjykatës mbi kërkesat akcesore:

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 463 të LPK-së, i cili parasheh “463.1 Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. 463.2 Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës. 463.3 Pala duhet ta paraqes kërkesën për pagimin e shpenzimeve më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit që i paraprinë vendosjes mbi shpenzimet, e po që se është fjala për dhënien e vendimit pa u bërë shqyrtim paraprakisht, atëherë pala ka për detyrë që kërkesën për shpenzimet e procedurës ta parashtrojë në propozimin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë. 463.4 Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendos në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate. 463.5 Gjatë zhvillimit të procedurës gjykata vendosë me aktvendim të veçantë për pagimin e shpenzimeve të procedurës vetëm atëherë kur e drejta e shpërblimit nuk varet fare nga vendimi mbi çështjen kryesore”. Meqenëse paditësi nuk ka specifikuar shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me publikimin e aktgjykimit:



Gjykata vendosi në përputhje me nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrativ. Në bazë të këtij neni, i cili përcakton se: *Aktgjykimi i arsyetuar dhe pasi ka marrë formë të prerë, publikohet në të njëjtën mënyrë në të cilën është publikuar vetë akti, për efekt të hyrjes në fuqi.* Bazuar në këtë dispozitë ligjore gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Publikimi i aktgjykimit kontribuon në transparencën e punës së gjykatës, në forcimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe në udhëzimin e autoriteteve publike dhe qytetarëve lidhur me të drejtën dhe praktikën administrative. Duke pasur parasysh se rregullorja nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, gjykata vlerësoi se është e nevojshme që ky aktgjykim të bëhet i qasshëm për publikun, në mënyrën e njëjtë të publikimit të aktit nënligjor normativ për efekt të hyrjes në fuqi, konform nenit 70 paragrafi 2 të LKA-së.

Për arsyet e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 10 paragraf 4, 11 paragraf 3, 59, 60 par.1, 70 dhe 101 paragraf 1 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË

P.A.nr.11/2025 të datës 14.07.2025

B. Profesionale
Zanë Buçinca

Kryetare e kolegjit
Delushe Halimi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.
(neni 10 paragraf 4 i LKA-së)



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

vertetohet se sot
Potvrdijem da sam danas

30. 07. 25

(Data të shënohet me fjalë - Datum ispisati slovima)

201.....

e kam marrë në dorëzim e shënuar në faqen e parë
primio sam pošiljku ozanacenu na prvoj strani

NËNSHKRIMET

Marrësi - Primalac

POTPIS

Dorëzuesi - Dostavljač

(Të panevojshme bjeru vizë - Nepotrebno precrati)

1. Pasi marrësi nuk gjendet në vendin ku duhej të kryhej dërgesa as pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën e vet, në vendin e punës dorëzimi ju bë anëtarit madhor të familjes së marrësit-kujdestarit të ndërtësës, fqit-personit që punon në të njejtin vend pune me marrësin

1. Pošto primalac nije yatecen na mestu gde se dostavljanja ima izvršiti poslo ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja u određeno vreme u svom stanu odnosno na radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćinstva, primaoca-nastojniku zgrade-seseda licu zaposlenom na istom radnom mestu s primaocem.

(Emri e mbiemri - Prezime I ime)

Vërejtje e dërguesit në rast mosdorëzimi
Napomena dostavljača u slučaju neisporuke

2. Pasi marrësi apo anëtarin e familjes së tij refuzoi marrjen, shkryesa iu la në banesë-në vendin e punës së marrësit (in ngijt në derën e banesës apo të lokalit ku punon marrësi).

2. Pošto je primalac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismeno je dostavljeno u stanu-radnom mestu primaoca (pribijeno na vratima stana odnosno prostorije gde je primalac zaposlen).

më në orën
dana u Casonva

Shkaku u refuzimit

Razlog odbijanja

(Nënshkrimi i dorëzuesit - Potpis dostavljača)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruaj, nënshkruan dërguesi duke shënuar shkaku për marrësi i vuri nënshkrimin e vet.
Ako je primalac nepismen ili nije u stanu da se potpiše potpisuje ga dostavljač, s napomenom zašto primalac nije stavio svoj potpis

FLETËKTHESA - POVRATNICA

Numër. P. A. nr. 11/2025
Broj.....

Lënda e dërgesës - Predmet dostave

28.07.2025

Dorëzuar postës AKGJUKIM 14.07.2025
Predato na

Në adresë UNIVERSITETI
Na adresu

"HAXHI ZEKA NR PEJË"

Në RUGA UGK 30000 PEJË
Na

Adresa:

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

--	--	--	--	--